



**REPUBLIKA E SHQIFËRISË  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**UDHËZIM**

**Nr. 3 date 13.11.2006**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NE UDHEZIMIN NR. 265, DT 04. 12. 2002  
"PËR SHPENZIMET PROCEDURALE"**

***Me synim,***

- për të përmiresuar punën në llogaritjen dhe dokumentimin e shpenzimeve' prGeedurale; qe parapaguhen nga shteti sipas dispozitave ligjore, nënligjore apo tarifave në fuqi;
- për të shmangur problemet e evidentuar në praktikën e zbatimit të këtij udhëzimi dhe për të garantuar pagimin e shpenzimeve procedurale si detyrim ndaj shtetit.

**Në mbështetje,** tënenit 24 pika 4, 485-487, 286, 330 e vijues të K. Pr. Penale-dhe nenit 8 pika 2 të.ligjit nr. 8737, datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**U D H E Z O J :**

1. Udhëzimin e Prokurorit te Pergjithshem nr. 256, date 4.12.2001 "Për shpenzimet procedurale", behen ndryshimet dhe shtesat si me poshte:

1.1 Pika 1.3.1 ndryshohet si vijon:

"1.3.1 shpenzimet për **ekspertimin kriminalistik** që është kryer, te llogaritur sipas llojit te tij, mbështetur **në tarifat e ekspertimeve kriminalistike ne fuqi;**"

1.2 Pika 1.3.2 ndryshohet si vijon:

"1.3.2 shpenzimet per shërbimin **mjeko-ligjor** që është kryer, te llogaritur sipas llojit te tij, mbështetur **ne tarifat e shërbimeve mjeko-ligjore ne fuqi;**"

1.3 Pika 1.3.3 ndryshohet si vijon:

“1.3.3 shpenzimet **per ekspertimet kontabël, autoteknik ose lloje te tjera ekspertimesh teknike**, te llogaritura mbështetur **ne tarifate orare ne fuqi** sipas llojit te **ekspertimit**, ndersa kur nuk ka **tarifate miratuara mund** te perdoren tarifate orare ne fuqi per shërbimet analoge;”

1.4 Pika 1.5 ndryshohet si vijon:

“1.5 Ne **shpenzimet per mbrojtësit e caktuar kryesisht** te përfshihen shpenzimet e dokumentuara qe jane kryesisht per mbrojtësit e caktuar kryesisht, sipas **tarifave ne fuqi te shpërblimit tavan per ndihmen juridike qe japin avokatet.**”

1.5 Pika 1.6.1 ndryshohet si vijon:

“1.6.1 shpenzimet e përkthimit zyrtar te llogaritura sipas **tarifave ne fuqi per shpërblimin e përkthyesve te jashtem.**”

1.6 Pas pikes 6 shtohet pika 6.1 me kete: përmbajtje:

“6.1 Ne përfundim te hetimeve, kur per veprat penale qe ndiqen mbi ankim **vendoset pushimi i ceshtjes per shkak se fakti nuk ekziston**, ne pjesen arsyetuese dhe ne diapozitivin e vendimit **prokurori duhet te shprehet se i ngarkohet ankuesit shumate e shpenzimeve procedurale te parapaguara nga shteti**<sup>1</sup>. Ne keto raste, **mbi kerkesen e te pandehurit ose te paditurit civil, ankuesi ngarkohet edhe me shpenzimet e bera nga i pandehuri dhe/ose i padituri civil, si dhe me shpërblimin e demit.**”

1.7 Pas pikës 6.1 shtohet pika 6,2 me këtë përmbajtje:

“6.2 Kur vendoset pushimi i çështjes për shkak të tërheqjes së **ankimit** ne pjesen arsyetuese dhe diapozitivin e vendimit, **prokurorl duhet të shprehet se i ngarkohet ankuesit shumate e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti, përveçse kur** ne aktin e tërheqjes eshte parashikuar me marrëveshje që shpenzimet procedurale janë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të personit kundër te cilit është berë ankimimi<sup>2</sup> . ,

2. Per zbatimin, e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët, oficerët e policise gjyqesore dhe punonjësit, që mbulojnë veprimtari ekonomike në prokurori, ndërsa per të konfrolluar zbatimin e tij ngarkohen drejtuesit e prokurorive të të gjithë niveleve, kancelaret dhe kryesekretarët, aty ku nuk ka kancelar si dhe Drejtoria Ekonomike dhe Sekretari i Përgjithshëm pranë kësaj Zyre.

3. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët, drejtuesit e Prokurive të të gjithë niveleve, si dhe personat e tjerë qe ngarkohen me zbatimin dhe

<sup>1</sup> Shih nenin 330 pikat' 1, 2 e 4 të K.Pr.Penale.

<sup>2</sup> Shih po aty nenet 286 pika 3 dhe 330 kipa 3 dhe 4

kontrollin e zbatimit të tij.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjeherë.

**PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

**THEODHORI SOLLAKU**

